

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 AGENCIA KOSOVARE KUNDËR-KORRUPSIONIT
 AGENCIJA ZA BORBË PROTIV KORRUPCIE NA KOSOVU
 KOSOVO ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D Nr. Prot. 01-174/10
 Dep. 2-D Nr. Prot. 01-174/10
 Dep. 2-D Prof. No. 01-174/10

Nr. i faq. 04-02-2010
 Broj stranica 04-02-2010
 Nr. pages 04-02-2010

PRISHTINË



DOGANA E KOSOVËS
 CARINA KOSOVA
 KOSOVO CUSTOMS

Dalje - Izlaz - Passing

Nr/Br/No. 121/04-02-10
 Drejtoria - Uprava - HQ
 1

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO

MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCËVE – MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE – MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE



AGJENSIONI KOSOVAR KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA ZA BORBË PROTIV KORRUPCIE NA KOSOVU
 KOSOVO ANTI-CORRUPTION AGENCY



DOGANA E KOSOVËS
 CARINA KOSOVA- KOSOVO CUSTOMS

MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT

NË MES TË

DOGANËS SË KOSOVËS,

DHE

AGJENSIONIT KOSOVAR KUNDËR KORRUPSION

MBI

BASHKËPUNIM DHE ASISTENCË TË DYANSHME PËR

ÇËSHTJE E INTERESIT TË PËRBASHKËT

Duke u bazuar ne rendësin dhe nevojën e bashkëpunimit ne mes te Doganës se Kosovës (DK) dhe Agjensionit Kosovar Kundër Korrupsion (AKK) ne avancimin e mëtutjeshëm te marrëdhënieve reciproke;

Duke u bazuar ne detyrat specifike dhe te përbashkëta te palëve nënshkruese te këtij Memorandumi te bashkëpunimit (MB), ne luftën kundër krimit te organizuar, dhe luftimin e dukurive korruptive, si dhe parandalimin e te gjitha dukurive negative qe rrezikojnë rendin dhe sigurinë publike.

Duke konsideruar qe DK-ja dhe AKK-ja (këtu me poshtë do te quhen "Palët") dëshirojnë te bashkëpunojnë ne kuadrin e funksioneve te tyre ligjore për te zbatuar, mbikëqyrur dhe rregulluar aktivitetet e tyre, brenda kompetencave ligjore te tyre;

Duke konsideruar se Palët dëshirojnë që nëpërmjet një bashkëpunimi te tille te ndihmojnë njëra tjetrën ne realizimin e përgjegjësive te tyre respektive dhe te nxisin një funksionim me te mire te aktiviteteteve nga fushë veprimtaria qe bije nen kuadrin e kompetencave te tyre; dhe

Duke konsideruar se Palët dëshirojnë qe nëpërmjet një bashkëpunimi te tille te nxisin dhe te zgjerojnë gjithashtu shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencën mbi çështjet me interesa te përbashkëta.

Me qellim qe te shprehët gatishmëria e tyre për të bashkëpunuar mbi bazën e besimit dhe mirëkuptimit reciprok ku edhe u pajtuan që të bazojnë bashkëpunimin e tyre në fushat e përcaktuara sipas këtij MB.

Për ketë arsye, Palët kane rënë dakot si me poshtë:

I. Definimet

Termet e mëposhtme do te kenë kuptimin me sa është ne vijim:

"MB" Nënkupton Memorandumi i Bashkëpunimit;

"DK" Nënkupton Doganën e Kosovës;

"AKK" Nënkupton, Agjensionin Kosovar Kundër Korrupsion.;

"Ligji doganor" nënkupton dispozitat statusore dhe dispozitat e rregullta te cilat aplikohen prej DK-së ne lidhje me fushë veprimtarinë e saj;

"Ligji Kundër Korrupsion" nënkupton dispozitat juridike që i zbaton Agjensioni Kosovar Kundër Korrupsion;

"palës që i bëhet kërkesa" nënkupton Administratën te e cila kërkesa për asistencë administrative në baze të këtij MOU është adresuar; dhe

"pala që kërkon" nënkupton Administratën te e cila dërgon një kërkesë për asistencë administrative sipas këtij MOU.

II

Sfera e bashkëpunimit

Palët janë pajtuar që:

1. Te asistojnë njëra tjetrën për çështjet që janë me interes të dyanshme në fushën e parandalimit, hetimit dhe ndalimit të dukurive korruptive dhe veprave penale,
2. Te shkëmbejnë informacione dhe të bashkëpunojnë në hetimin e rasteve që rezultojnë me veprimtari kriminale të korrupsionit.
3. Te mbajnë njërit tjetrin të informuar për ligjet relevante, dhe çdo ndryshim të rëndësishëm, të aplikueshëm në fushë veprimtarin e tyre respektive.
4. Të bashkëpunojnë plotësisht në realizimin e pikave që dalin nga neni 23 i Ligjit Kundër Korrupsionit nr. 2004/34, nga secila palë nënshkruese e këtij memorandumi që iu takon konform akteve ligjore të cekura më lart.
5. Pa rënë ndeshje me ligjet e tyre, dhe sipas kërkesës apo iniciativës së palës tjetër, të ofrojnë asistencë teknike të ndërsjellët në procesin hetimor, që do të ndihmoni palët nënshkruese të MB-së që të zbatojnë në mënyrë sa më të drejt kompetencat e tyre në fushën e zbatimit të ligjit.
6. Tërë asistencë e dhënë prej palëve sipas këtij Memorandumi do të bëhet në pajtueshmëri me ligjet e aplikueshme prej të dy palëve dhe secila palë mundet të përcaktoj ndalesa të caktuara në shfrytëzimin e informatave dhe të dhënave.
7. Palët nënshkruese të këtij Memorandumi pajtohen që të zgjerojnë fushën e bashkëpunimit në luftimin e korrupsionit edhe përmes formave të tjera si:
 - a) Trajnimet e përbashkëta;
 - b) Pjesëmarrja në Seminare të përbashkëta;

